



**Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Gjykata Kushtetuese / Ustavni sud / Constitutional Court**

Prishtinë, 30 prill 2010
Nr. ref.: RK 29/10

VENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

Rasti nr. KI 01/09

Parashtruesi i kërkesës

Ismet Bajrami

kundër

Palës kundërshtare

NewCo Ferronikeli Complex sh.p.k.

GJYKATA KUSHTUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare, dhe
Iiriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës.

1. Parashtrues i kërkesës është Ismet Bajrami, nga fshati Oshlan, Vushtrri, Kosovë.

Pala kundërshtare

2. Pala kundërshtare është NewCo Ferronikeli Complex shpk, adresa: 37, L. e Pejës rruga 4, 12000 Fushë Kosovë

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës, pa përfaqësues ligjor, parashtroi një Kërkesë në Gjykatën Kushtetuese më 9 shkurt 2009, duke pohuar shkeljen e të drejtës për punë, që sipas tij rrodhi nga praktikat diskriminuese në punësim. Në veçanti, parashtruesi i kërkesës, theksoi se atij i ishte refuzuar punësimi për shkak se “vinte nga një komunë tjetër”.

Faktet

4. Parashtruesi fillimisht ishte i punësuar në ish-Ndërmarrjen Shoqërore “Ferronikeli”, në Glllogoc-Drenas. Ai ishte punësuar si mekanik i makinerisë në postin e “operatorit i të depos kryesore të mazutit.
5. Parashtruesi filloi të punonte në “Ferronikeli”, më 20 prill 1984. Për shkak të ngjarjeve që shkaktuan trazirat në Kosovë, ndërmarrja ndaloi veprimtarinë në vitin 1998, ashtu që parashtruesi i kërkesës ngeli pa punë.
6. Ndërmarrja më pas, më 4 prill 2006, u privatizua dhe u themelua një kompani e re, NewCo Ferronikeli Complex sh.p.k, - pala kundërshtare në këtë rast. Pala kundërshtare punësoi 1,000 punonjës, megjithatë, parashtruesi nuk u përfshi në mesin e të punësuarve gjatë procesit të përzgjedhjes nga menaxhmenti i ri. 900 ish-punonjës nuk u përzgjedhën gjatë procesit të punësimit.

Baza juridike

7. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme - Kushtetuta); Neni 20 i Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme - Ligji), dhe Neni 54(b) i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

Përmbledhje e procedurës para Gjykatës

8. Më 9 shkurt 2009, parashtruesi dorëzoi një kërkesë në Sekretarinë e Përkohshme të Gjykatës Kushtetuese. Më 11 shkurt 2009, Gjykata e informoi me shkrim parashtruesin për pranimin e kërkesës dhe kërkoi nga parashtruesi që ta plotësonte formularin e kërkesës. Formulari i plotësuar u dorëzua më 4 dhjetor 2009.
9. Kryetari i Gjykatës, emëroi gjyqtaren Snezhana Botusharova në cilësinë e Gjyqtare Raportuese. U formua Kolegji Shqyrtues në përbërje të gjyqtarit Altay Suroy, kryesues, dhe gjyqtarëve Gjyljeta Mushkolaj dhe Almiro Rodrigues.
10. Më 10 dhjetor 2009, Gjykata njoftoi palën kundërshtare për parashtrimin e kërkesës dhe ia dërgoi një kopje të kërkesës, të cilës ajo duhej t'i përgjigjej. Pala kundërshtare e dorëzoi përgjigjen më 15 dhjetor 2009. Në përgjigje theksohej se parashtruesi ishte njëri nga 900 ish-punonjësit e ish-ndërmarrjes "Ferronikeli", që nuk u përzgjedhën në procesin e punësimit për kompaninë e privatizuar.
11. Po ashtu, në përgjigjen e tyre ata theksuan se ish-punonjësit që nuk u përzgjedhën në procesin e punësimit, kishin të drejtë të konkurronin në Agjencinë Kosovare të Privatizimit për realizimin e të drejtave të tyre për punësim. Ata mohuan që parashtruesi ishte më parë i punësuar, ose kishte marrëdhënie pune me kompaninë e re NewCo Ferronikeli Complex sh.p.k.

12. Një kopje e përgjigjes së palës kundërshtare, iu dërgua parashtruesit më 5 shkurt 2010 dhe atij i kërkohej t'i trajtonte aspektet kontestuese të rastit të tij, të ngritura nga pata kundërshtare. Po ashtu, atij i kërkohej të ofronte hollësi për masat që i kishte ndërmarrë për t'i realizuar të drejtat e tij për punësim, në ndonjë gjykatë a tribunal tjetër.
13. Parashtruesi iu përgjigj Gjykatës përmes një shkrese, më 10 shkurt 2010. Në përgjigjen e tij, ai theksoi se kishte vështirësi në sigurimin e dokumenteve të caktuara, të kërkuara nga Gjykata. Megjithatë, ai nuk kishte dhënë hollësi të hapave që i kishte ndërmarrë për t'i realizuar të drejtat e tij para ndonjë gjykate a autoriteti administrativ, ose nëse kishte ushtruar mjete lokale juridike që mund t'i ketë pasur në dispozicion.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

14. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata, së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet Nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton: "Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."
15. Gjykata dëshiron të theksojë se arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t'ua ofrojë autoriteteve në fjalë, përfshirë edhe gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi ligjor i Kosovës, do të sigurojë mjet efikas ligjor për shkeljen e të drejtave kushtetuese (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Selmouni v. France, nr. 25803/94, Vendim i 28 korrikut 1999). Megjithatë, nuk është e nevojshme që të drejtat kushtetuese të ceken në mënyrë eksplicite në procedurën në fjalë. Dhe se çështja ishte ngritur në mënyrë implicite, ose në substancë, rregulli i shterimit të mjeteve juridike është plotësuar (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Azinas v. Cyprus, nr. 56679/00, Vendim i 28 prillit 2004).
16. Kjo Gjykatë e ka përdorur të njëjtin arsyetim kur mori vendim për papranueshmëri, më 27 janar 2010, mbi bazën e mos-shterjes së mjeteve ligjore në Rastin nr. KI. 41/09 të Universitetit AAB-RIINVEST sh.p.k., Prishtinë, kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, dhe në Vendimin e 23 marsit 2010 në Rastin nr. KI 73/09, të Mimoza Kusarit kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
17. Duke pasur këtë parasysh, nga dokumentacioni i dorëzuar, shihet qartë që ka mungesë të plotë të dëshmive para Gjykatës, se parashtruesi ka ndërmarrë hapa për ta realizuar kërkesën e tij në gjykata a autoritete të tjera administrative, të cilat mund t'i ketë pasur në dispozicion. Prandaj, ai nuk i ka shteruar të gjitha mjetet ligjore të ofruara me ligj, siç kërkohej, në mënyrë që të mund ta parashtrojë kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE

18. Gjykata, pas shqyrtimit të të gjitha fakteve dhe dëshmive të ofruara, dhe pas shqyrtimit të çështjes më 30 prill 2010, përfundoi se parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet ligjore në dispozicion dhe njëzëri:

VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme.
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me Nenin 20.4 të Ligjit mbi Gjykatën Kushtetuese.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

Gjyqtari raportues

Snezhana Botusharova, d.v.



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani, d.v.